



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-1097

Në bazë të nenit 21 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 nr. 350/02-0281166/18/1 dt. 07.06.2019, të kërkueseve/pronarit Ibrahim Llumnica nga Prishtina, dhe Investitorit “Joni Construction” shpk, me përfaqësues Arben Llumnica nga Prishtina, për miratimin e kërkesës për plotësimin dhe ndryshimin të Vendimit të Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, të lëshuar nga kjo Drejtori, në emër të pronarëve: Arsim Maxhuni dhe Beqir Rexhepi nga Prishtina, me Investitor “Redoni” shpk, me përfaqësues Gazmend Maxhuni, Vehbi Maxhuni dhe Fadil Maxhuni nga Prishtina, (grupi I-rë i interesit), dhe Ilir Llumnica dhe Ibrahim Llumnica nga Prishtina, me Investitor “Joni Construction” shpk, me përfaqësues Arben Llumnica nga Prishtina (grupi i II-të i interesit), për hartimin e dokumentacionit ndërtimor, për lejimin e ndërtimit të 2 (dy) ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, në kuadër të bllokut urbanistik “A15”, të tërësisë “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit në procedurë të rregullt administrative, me datë 17.07.2019, merr këtë::

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E KUSHTEVE NËRTIMORE
05 NR. 350/02-0281412/18 DHE 05 NR. 350/02-0281166/18, TË DATËS 28.02.2018

I. Ndryshohen dhe Plotësohen Vendimi i Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-0281166/18/1 dt. 07.06.2019, të pronarit Ibrahim Llumnica nga Prishtina, të lëshuara nga kjo Drejtori, me anë të cilit janë caktuar Kushtet Ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, Lam. “Redoni” Shpk, me etazhitet -B+S+P+8, si dhe pronarëve Ilir Llumnica dhe Ibrahim Llumnica nga Prishtina, me investitor “Joni Construction” shpk, me përfaqësues Arben Llumnica nga Prishtina (grupi i II-të i interesit), me etazhitet -B+S+P+6, si dhe “aneksi” me destinim garazhues, me etazhitet -2B, në kuadër të Bllokut urban “A15”, tërësia “A”, të Planit Rregullues “Mati 1” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 680-3, 680-2, 682-26 dhe 681-5 ZK Matiçan (tani parcela ndërtimore nr. 1651-0 ZK Matiçan).

Ndryshimi dhe plotësimi i vendimit të lartcekur, ka të bëjë me pikat si në vijim:

- Në paragrafin I. /I caktohen kushtet ndërtimore... / fshihet parcela kadastrale nr. 680-2 ZK Matiçan, me pronar Ibrahim Llumnica nga Prishtina;
- Në paragrafin III. /Gjendja ekzistuese.../ pika 2 dhe 4, fshihet parcela kadastrale nr. 680-2 ZK Matiçan me pronar Ibrahim Llumnica, ” Arë e klasit 5”;
- Në paragrafin IV. /Kushtet Ndërtimore.../ pika 3, fshihet parcela kadastrale nr. 680-2 me sipërfaqe $S=49m^2$, dhe sipërfaqja totale mbetet $S=121m^2$;
- Në paragrafin IV. /Kushtet Ndërtimore.../ pika 4, nga teksti i shënuar:

Grupi I-rë i interesit - "Redoni shpk": $S=4654.92m^2/4409.92m^2$, mbi tokë + $245m^2$, nën tokë/
Etazhiteti: $-B+S+P+8$,

Grupi II-të i interesit - "Joni Construction": $S=2969.30m^2/2450.50m^2$, mbi tokë + $518.85m^2$, nën tokë/

Etazhiteti: $-B+S+P+6$,

"Aneksi" - garazha: $S=734.00m^2/0.00m^2$, mbi tokë + $734.00m^2$, nën tokë/

Etazhiteti: $-2B$,

ndryshohet në atë:

Grupi I-rë i interesit - "Redoni shpk": $S=4654.92m^2/4409.92m^2$, mbi tokë + $245m^2$, nën tokë/
Etazhiteti: $-B+S+P+8$,

Grupi II-të i interesit - "Joni Construction": $S=2913.45m^2/2394.60m^2$, mbi tokë + $518.85m^2$, nën tokë/

Etazhiteti: $-B+S+P+6$,

"Aneksi" - garazha: $S=734.00m^2/0.00m^2$, mbi tokë + $734.00m^2$, nën tokë/

Etazhiteti: $-2B$,

- Në paragrafin IV. /Kushtet Ndërtimore.../ pika 10, fshihet nënpika "B2".
- Në paragrafin IV. /Kushtet Ndërtimore.../ pika 11, fshihet nënpika $49 \times 3.0 = 147m^2$, dhe sipërfaqja totale ndërtimore e trajtuar jashtë vijës rregulluese ndryshohet nga " $S=1172.40m^2$ ", në atë " $S=1025.40m^2$ ", dhe sipërfaqja totale ndërtimore për dy grupet interesit nga $S=6861.00m^2$, do të jetë $= 6714.00m^2$ (sip. totale mbi tokë e lejuar për ndërtim).
- Në paragrafin V. /Kompensimi.../, fshihet parcela kadastrale nr. 680-2 ZK Matičan.
- Në paragrafin VI. /Ndarja - parcelimi.../, fshihet parcela kadastrale nr. 680-2 ZK Matičan.

II. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, i caktimit të kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejin e ndërtimit të kompleksit të ndërtesave shumëbanesore me afarizëm, i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, dhe i njëjti do të prodhoj efekte juridik nga dita e miratimit të tij.

A r s y e t i m

Pronari Ibrahim Llumnica nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-0281166/18/1 dt. 07.06.2019, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, miratimin e ndryshimit të Vendimit të Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, me anë të cilit janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për lejin e ndërtimit të kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, Lam. "Redoni" Shpk, me etazhitet $-B+S+P+8$, si dhe pronarëve Ilir Llumnica dhe Ibrahim Llumnica nga Prishtina, me investitor "Joni Construction" shpk, me përfaqësues Arben Llumnica nga Prishtina (grupi i II-të i interesit), me etazhitet $-B+S+P+6$, si dhe "aneksi" me destinim garazhues, me etazhitet $-2B$, në lokacionin e përshkruar në pikën I. të dispozivit të këtij Vendimi.

Bashkëngjitur me kërkesë kërkuuesi ka prezantuar: fotokopjen e pa vërtetuar të Vendimit të Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, të caktuara nga kjo Drejtoria, kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale për parcelat kadastrale nr. 680-6, 680-7 dhe 680-8 ZK Matičan (e fituar si rezultati ndarjes së parcelës kadastrale nr. 680-2 ZK Matičan); Kopjen

e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale për parcelat kadastrale nr. 680-5 dhe 680-4 ZK Matiçan; Fotokopjen e Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës, me anë të cilës aprovohet kërkesa për ndarjen dhe përmirësimin e sipërfaqes të njësisë/ve kadastrale nr. 680-3 në pronësi të Ilir Lluminca, situacionet e ngushta me ndryshimet e kërkuara e punuar nga kompania projektuese "Arcadis" shpk, me bartës të projektit i.d.a. Naim Matoshi nga Prishtina.

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, dokumentet e planifikimit hapësinor për hapësirën në fjalë, dhe hulumtimit të arkivit të kësaj drejtorie, ka konstatuar se, për këtë çështja janë zhvilluar procedurat administrative të cilat në mënyrë kronologjike paraqiten si në vijim:

Pronarët, Arsim Maxhuni, Beqir Rexhepi me investitor "Redoni" shpk, me përfaqësues Gazmend Maxhuni, Vehbi Maxhuni dhe Fadil Maxhuni nga Prishtina, (grupi I-rë i interesit), me kërkesën 05 nr. 350/02-0281166/18 dt. 26.11.2018, për rihapjen e procedurës së kërkesës për caktimin e kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0157876/18 dt. 03.07.2018, si dhe pronarët Ilir Llumica dhe Ibrahim Llumica nga Prishtina, me investitor "Joni Construction" shpk, me përfaqësues Arben Llumica nga Prishtina (grupi i II-rë i interesit), me kërkesën 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. 26.11.2018, i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit të Komunës së Prishtinës për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, Lam. "Redoni Shpk", me etazhitet -B+S+P+8, si dhe pronarëve Ilir Llumica dhe Ibrahim Llumica nga Prishtina, me investitor "Joni Construction" shpk, me përfaqësues Arben Llumica nga Prishtina (grupi i II-të i interesit), me etazhitet -B+S+P+6, si dhe "aneksi" me destinim garazhues, me etazhitet -2B, në kuadër të Bllokut urban "A15", tërësia "A", të Planit Rregullues "Mati 1" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 680-3, 680-2, 682-26 dhe 681-5 ZK Matiçan, dhe janë pajisur me Vendimin e Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018.

Pas pranimit të Kushteve Ndërtimore investitori "Redoni" shpk (Grupi I-rë i interesit), me kërkesën me nr. 05 nr. 351/02-123982/19 dt. 04.07.2019, i është drejtuar kësaj drejtorie për lejimin e ndërtimit të lam. "Redoni".

Në ndërkohë, Ibrahim Llumica nga Prishtina, me kërkesën 05 nr. 350/02-0281166/18/1 dt. 07.06.2019, në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr. 680-2 ZK Matiçan (tani e ndarë në parcelat kadastrale nr. 680-6, 680-7 dhe 680-7 ZK Matiçan), ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, heqjen tërësisht nga Vendimi i caktimit të kushteve ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, parcelën kadastrale nr. 680-2 ZK Matiçan, me arsyetimin se parcela kadastrale nr. 680-2 ZK Matiçan, më herët është trajtuar në ndërtim me investitorin "Alb Vision" në vitin 2012, duke mos prezantuar dëshmi konkrete.

Drejtorja e Urbanizmit pas pranimit të kërkesës me nr. 05 nr. 350/02-0281166/18/1 dt. 07.06.2019, dhe pas verifikimit të arkivit të Drejtorisë për dosjet e lëndëve paraprake, për konstatimin e përfshirjes apo mospërfshirjes së parcelës kadastrale nr. 680-2 ZK Matiçan, për të cilën ka informuar Ibrahim Llumica përmes kërkesës së lartcekur, me Vendim ka pezulluar procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës për leje ndërtimore 05 nr. 351/02-123982/19 dt. 04.07.2019, të pronarëve Rexhep Beqiri, Ilir Llumica dhe Arsim Maxhuni nga Prishtina, me investitor "Redoni" shpk, me certificate të regjistrimit të biznesit 810196320, me përfaqësues Arsim Maxhuni nga Prishtina, për lejimin e ndërtimit të ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+S+P+9, në kuadër të bllokut urban "A15", të Planit Rregullues "Mati 1", përkatësisht në parcelën kadastrale nr. 1651-0 ZK Matiçan.

Gjithashtu, pas hulumtimit të arkivit të kësaj Drejtorie dhe asaj të Kadastrit dhe Pronës të Komunës së Prishtinës, është konstatuar se, Ibrahim Llumica pronar i parcelës kadastrale nr. 680-0 ZK Matiçan, me sipërfaqe prej 4057m², në vitin 2012 fillimisht ka ndarë parcelën e tij në:

1. Parcela kadastrale nr. 680-1 me sipërfaqe prej 2976m² (shtrihet në bllokun urbanistik "A14")
2. Parcela kadastrale nr. 680-2 me sipërfaqe prej 109m² (shtrihet në rrugë të planifikuar në mes të blloqeve urbanistike "A14" dhe "A15")

3. Parcela kadastrale nr. 680-3 me sipërfaqe prej 998m² (shtrihet në bllokun urbanistik "A15")

Parcela kadastrale nr. 680-2 ZK Matičan, e cila shtrihet në rrugë të planifikuar të Planit Rregullues "Mati 1", në vitin 2019, bazuar në Vendimin e Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, është ndarë në parcelat kadastrale nr. 680-6, 680-7 dhe 680-8 ZK Matičan.

Parcela kadastrale nr. 680-3 ZK Matičan, e cila shtrihet pjesërisht në bllokun urbanistik "A15", dhe pjesërisht në rrugë të planifikuar të Planit Rregullues "Mati 1", në vitin 2019, bazuar në Vendimin e Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, është ndarë në parcelat kadastrale nr. 680-5 (pjesë që shtrihet në rrugë të planifikuar), ndërsa pjesa tjetër që shtrihet në bllokun urbanistik "A15", është bashkuar me parcela tjera kadastrale duke formuar parcelën ndërtimore nr. 1651-0 ZK Matičan.

Gjithashtu, bazuar në dosjet e lëndëve sipas kërkesave 05-350-22087 dt. 14.08.2009 (kërkesë për kushte urbanistike) dhe 05-351-31830 dt. 04.12.2009 (kërkesë për leje ndërtimi), është konstatuar se Ibrahim Llumnica, pronar i parcelë kadastrale nr. 680-0 ZK Matičan (me sipërfaqe prej 4057m²), ka lidhur kontratë për bashkë-investim për tërë sipërfaqen e parcelës, me investitorin "Alb Vision Construction", të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë Vr. Nr. 6390/2009 dt. 14.08.2009 (originaliteti i vërtetuar Drejtoria e Administratës dhe Personelit e Komunës së Prishtinës nr. 01/7167 dt. 14.08.2009), me të cilën dështohet se është trajtuar edhe sipërfaqja e parcelës prej 109m², tani e ndarë në parcelat kadastrale nr. 680-6, 680-7 dhe 680-8 ZK Matičan.

Po ashtu, në dosjen e kërkesës për leje ndërtimi 05-351/36089 dt. 03.10.2012, parashtruar kësaj Drejtorie, ndër të tjera është prezantuar edhe *"Kontrata mbi afarizmin e përbashkët për ndërtimin e objektit"* e lidhur në mes të Ibrahim Llumnica në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr. 680-0 ZK Matičan, me sipërfaqe prej 4057m², dhe investitorit "Alb Vision Costruction" të vërtetuar në Gjykata Komunale në Prishtinë Vr. Nr. 619/2010 dt. 29.01.2010 (originaliteti i vërtetuar në Drejtorinë e Administratës dhe Personeli nr. 01/11908 dt. 01.10.2012), është konstatuar se pronari ka lidhur kontratë për bashkë-investim për ndërtesat "1" dhe "2", të cilat shtrihen në bllokun urbanistik "A14", të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, me të cilën dështohet se është trajtuar edhe sipërfaqja e parcelës prej 109m², tani e ndarë në parcelat kadastrale nr. 680-6, 680-7 dhe 680-8 ZK Matičan.

Njëkohësisht, pronari i parcelës kadastrale Ibrahim Llumnica dhe investitori "Alb Vision Construction", i janë drejtuar kësaj drejtorie me kërkesë për pajisje me certifikatë të përdorimit për ndërtesat "1", "2" dhe "3", pasi këto ndërtesa paraprakisht janë pajisur me leje ndërtimi me Aktvendimet 05-351-36089 dt. 21.02.2013 dhe 05-351-31830 dt. 22.04.2010, dhe shtrihen në bllokun urbanistik "A14", të Planit Rregullues "Mati 1", në parcelën kadastrale aktuale nr. 680-1 ZK Matičan (e ndarë nga parcela bazë 680-0 ZK Matičan).

Në hulumtimin e kësaj lëndë, është verifikuar se për ndërtimin e ndërtesave "1", "2" dhe "3", janë shfrytëzuar sipërfaqet ndërtimore të parcelave kadastrale nr. 680-1 (me sipërfaqe prej 2976m²) dhe parcela kadastrale nr. 680-2 (me sipërfaqe prej 109m²). Nga kjo konstatohet se sipërfaqja e parcelës kadastrale nr. 680-2 ZK Matičan (me sipërfaqe prej 109m²), e cila është trajtuar edhe në kushtet ndërtimore të caktuara nga kjo Drejtori 05 nr. 350/02-0281412/18 dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, dhe e njëjta duhet të hiqet-fshihet nga Kushtet Ndërtimore, sepse sipas kalkulimeve kjo sipërfaqe është shfrytëzuar për ndërtimin e ndërtesave "1", "2" dhe "3", në bllokun urbanistik "A14", të Planit Rregullues "Mati 1".

Si konkludim përfundimtarë Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, bazuar në të dhënat e lartcekura, konstatoi se ndryshimi dhe plotësimi i kërkuar, përkatësisht heqja-fshirja nga vendimi i Kushteve Ndërtimore 05 nr. 350/02-0281412/18 dhe 05 nr. 350/02-0281166/18, të datës 28.02.2018, i parcelës kadastrale nr. 680-2 ZK Matičan (e ndarë në parcelat kadastrale nr. 680-6, 680-7 dhe 680-8 ZK Matičan), është i arsyeshëm dhe i obligueshëm për këtë drejtori pasi e njëjta më është trajtuar më herët dhe me shfrytëzimin e serishëm të saj do të ishte në kundërshtim me kriteret e parapara me Planin Rregullues "Mati 1" dhe Planin Zhvillimor Urban, dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Ndërtim 04-L/110 dt.

31.05.2012, andaj, kjo drejtori, vendosi që i njëjti ndryshim dhe plotësim, të miratohet përmes vendimit, gjegjësisht sipas përshkrimeve në këtë Vendim.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Shtojcë: Plani i situacionit i ndryshuar -"zgjidha urbane" e kompleksit me ndërtesa të planifikuara dhe hapësirat përcjellëse.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.


Ky Vendim është përpiluar në 9 (nëntë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/ve/Investitorit/ve, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë si dhe në dosjen e lëndëve bazë 05 nr. 350/02-0281166/18 dt. 26.11.2018 dhe 05 nr. 350/02-0281412/18 dt. 26.11.2018


**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-0281166/18/1 DT. 17.07.2019**

Zyrtari:
Zejnulla Rexhepi



U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Mimoza Berisha Prestreshi





Kompleksi AFARISTO-BANESORË - Mati 1 - PRISHTINE										
Llogaritja e Sipërfaqeve të lejuara										
Investitoret			Pronaret		Nr parc	Mbrenda Vijes rregulluese	Jashte Vijes rregulluese	Totali	Totali i të Gjitha parcelave	
	Joni Construction		Ilir Llumnica	Parcela	680-3	851	147	998	2468	m2
	Redoni Construction		Arsim Maxhuni	Parcela	682-26	655	19	674		m2
			Rexhep Beqiri	Parcela	681-5	570	226	796		m2
						2076	392	2468.00	0.188824663	Nuk kalon 20%
Total Parcela mbrenda Vijes rregulluese						2076	0.4	830.4	Shputa e Lejuar	
Koeficienti i mbulimit të ngastres	0.4		Total sipërfaqe per ndertim						m2	
Koeficienti i Shfrytëzimit të kateve	1.8									
Parcelat	680-3		682-26		681-5		Totali	Koeficienti		
Total sipërfaqja me koeficient 1.8	499						499	1.8	898.2	2395.2
Total sipërfaqja me koeficient 3.0	499						499	3	1497	
Total sipërfaqja me koeficient 3.0			674				674	3	2022	
Total sipërfaqja me koeficient 3.0					796		796	3	2388	4410
				Sipërfaqja total e parcelave që shfrytëzohet per ndertim		2468		Mbitoka e Lejuar	6805.2	

Studio Projektuese:
ARCADIS
tel: 044 209 086
Naim Matoshi IDA

Berat Salihu arch, Fatbardha Dervishi arch, Argjent Ferati arch, Nazif Arifi arch, Arjanit Zukaj arch
Prishtinë, shkurt 2019
www.studioarcadis.com

Pronarët: ILIR LLUMNICA, IBRAHIM LLUMNICA
Investitor: "JONI CONSTRUCTION" SH.P.K.
Destinimi: Afaristo-Banesorë
Vendi i Ndertimit: Parcela 680-4, Blloku A15, Mati 1, Prishtinë
Pjesa e projektit:
Situacioni i ngushtë

Faza: Arkitektura
Faza e projektit: Projekti kryesor

Perpjesa: 1:300
Faqja: 03